




Qendra Kosovare për Studime Gjinore  
Kosovar Gender Studies Center

MINISTRY OF FOREIGN AFFAIRS OF DENMARK  
**DANIDA** INTERNATIONAL  
DEVELOPMENT COOPERATION

 Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra

Swiss Cooperation Office Kosovo

# GRATË NË POZITA TË LARTA VENDIMMARRËSE NË SEKTORIN PUBLIK DHE PARTI POLITIKE





**GRATË NË POZITA TË LARTA  
VENDIMMARRËSE NË SEKTORIN  
PUBLIK DHE PARTI POLITIKE**

**Falënderim:**

“Gratë në Vendimmarrje në Sektorin Publik dhe Parti Politike” është hulumtim i Qendrës Kosovare për Studime Gjinore (QKSGJ), i realizuar nga AnketaCo. Ky hulumtim është publikuar në kuadër të projektit “Përmirësimi i llogaridhënies për barazi gjinore në vendimmarrje”, i mbështetur nga Projekti për Promovimin e Shoqërisë Demokratike (DSP), financuar nga Zyra Zvicerane për Bashkëpunim në Kosovë (SCO-K) dhe Ministria e Punëve të Jashtme e Danimarkës (DANIDA) si dhe menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF).

**Redaktore:** Luljeta Demolli

**Menaxhere e Hulumtimit:** Dafina Prekazi

**Perkthyes:** Fatmire Berisha

**Qendra Kosovare për Studime Gjinore (QKSGJ)** QKSGJ-ja ka kontribuar në përfshirjen gjinore që nga viti 2002 dhe ka bërë përpjekje të vazhdueshme për arritjen e barazisë gjinore në Kosovë. QKSGJ-ja deri më tani ka qenë nismëtare për të ndryshuar sistemin diskriminues në Kosovë, normat shoqërore dhe standardet e dyfishta, dhe ka qenë shumë aktive në monitorimin e institucioneve publike. Misioni i QKSGJ-së është integrimi i perspektives gjinore në të gjitha analizat, programet dhe politikat e të gjithë sektorëve të shoqërisë kosovare, përmes ngritjes së vetëdijes për çështje gjinore, zhvillimit të studimeve gjinore, krijimit të politikave të ndjeshme nga aspekti gjinor; përmes hulumtimeve; avokimit dhe lobimit.

Adresa: Rruga Nëna Terezë Nr. 18/1, 10000 Prishtinë – Kosovë,

Tel. +381 (0) 38 735 991

[www.kgscenter.net](http://www.kgscenter.net)

## **Klauzolë e përgjegjësise**

Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e vetme e QKSGJ-së dhe në asnjë mënyrë nuk pasqyron pikëpamjet e SCO-K-së, DANIDA-s dhe KCSF-së.

## **E drejta autoriale**

E drejta autoriale © Qendra Kosovare për Studime Gjinore (QKSGJ), Qershor 2017.

Të gjitha të drejtat të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, të shpërndahet ose të transmetohet në çfarëdo forme apo me çfarëdo mjeti, elektronik, mekanik, fotokopjimi, incizimi ose ndryshe, pa lejen paraprake të publikuesit, me përjashtim të rasteve të citimeve të shkurtra të shprehura në shqyrtime kritike dhe disa përdorimeve të tjera jokomerciale të lejuara me Ligjin për të Drejtat Autoriale.

# PËRMBAJTJA

<b>LISTA E GRAFIKONEVE.....</b>	<b>7</b>
<b>SHKURTESAT .....</b>	<b>8</b>
<b>1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE .....</b>	<b>9</b>
<b>2. METODOLOGJIA.....</b>	<b>12</b>
<b>3. KORNIZA LIGJORE.....</b>	<b>14</b>
<b>4. INFORMATA HYRËSE .....</b>	<b>17</b>
<b>5. TË GJETURAT KRYESORE .....</b>	<b>19</b>
5.1.1. Gratë në pozitat e larta vendimmarrëse në Qeveri.....	19
5.1.2. Gratë në pozita të larta vendimmarrëse në Kuvend.....	23
5.1.3. Gratë në pozita të larta vendimmarrëse në Presidencë .....	23
5.1.4. Gratë në pozita të larta vendimmarrëse në komuna .....	23
5.1.5. Gratë në pozitat e larta vendimmarrëse në agjenci të pavarura ....	29
<b>5.2. Gratë në pozita të larta vendimmarrëse në</b>	
<b>partitë kryesore politike .....</b>	<b>30</b>
5.2.1. Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) .....	31
5.2.2. VETËVENDOSJE! (VV) .....	32
5.2.3. Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) .....	33
<b>6. PËRFUNDIMET DHE REKOMANDIMET.....</b>	<b>35</b>
6.1. Përfundimet.....	35
6.2. Sugjerimet dhe rekomandimet .....	36
<b>7. REFERENCAT.....</b>	<b>38</b>

## LISTA E GRAFIKONEVE

<b>Grafiku 1.</b>	Pozitat e larta vendimmarrëse në Qeveri sipas viteve .....	20
<b>Grafiku 2.</b>	Pozitat e larta vendimmarrëse në Zyrën e Kryeministrit.....	21
<b>Tabela 3.</b>	Pozitat e larta vendimmarrëse në Ministri sipas viteve .....	22
<b>Grafiku 4.</b>	Pozitat e larta vendimmarrëse në Komuna - Drejtorët e Drejtorive Komunale .....	24
<b>Grafiku 5.</b>	Pozitat e larta vendimmarrëse në Komuna në vitin 2014....	25
<b>Grafiku 6.</b>	Pozitat e larta vendimmarrëse në Komuna në vitin 2015....	26
<b>Grafiku 7.</b>	Pozitat e larta vendimmarrëse në Komuna në vitin 2016....	28
<b>Grafiku 8.</b>	Pozitat e larta vendimmarrëse në Agjencitë e Pavarura në Kosovë sipas viteve 2014-2016 .....	30
<b>Grafiku 9.</b>	Pozitat e larta vendimmarrëse në LDK (2014-2016) .....	32
<b>Grafiku 10.</b>	Pozitat e larta vendimmarrëse në VV (2014-2016) .....	33
<b>Grafiku 11.</b>	Pozitat e larta vendimmarrëse në AAK (2014-2016) .....	34

## SHKURTESAT

<b>ABGJ</b>	Agjencia për Barazi Gjinore
<b>AAK</b>	Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës
<b>AMKMK</b>	Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës
<b>AKK</b>	Agjencia Kundër Korrupsionit
<b>AKP</b>	Agjencioni Kosovar I Privatizimit
<b>ARH</b>	Autoriteti Rregullativ I Hekurudhave
<b>AShMDHP</b>	Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave
<b>BQK</b>	Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
<b>KPMM</b>	Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale
<b>KPM</b>	Komisioni I Pavarur për Media
<b>KQZ</b>	Komisioni Qendror I Zgjedhjeve
<b>QKSGJ</b>	Qendra Kosovare për Studime Gjinore
<b>MBPZHR</b>	Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
<b>MKK</b>	Ministria për Komunitete dhe Kthim
<b>MKRS</b>	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
<b>MDIA</b>	Ministria e Diasporës
<b>MZHE</b>	Ministria e Zhvillimit Ekonomik
<b>MIE</b>	Ministria e Integritimit Evropian
<b>MASHt</b>	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
<b>MF</b>	Ministria e Financave
<b>MPJ</b>	Ministria e Punëve të Jashtme
<b>MSH</b>	Ministria e Shëndetësisë
<b>MI</b>	Ministria e Infrastrukturës
<b>MPB</b>	Ministria e Punëve të Brendshme
<b>MD</b>	Ministria e Drejtësisë
<b>MFSK</b>	Ministria e Forcës dhe Sigurisë e Kosovës
<b>MAPL</b>	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
<b>MPMS</b>	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
<b>MMPH</b>	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
<b>MAP</b>	Ministria e Administratës Publike
<b>MTI</b>	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
<b>ZK</b>	Zyra e Kryeministrit
<b>OShP</b>	Organi Shqyrtues i Prokurimit
<b>LDK</b>	Lidhja Demokratike e Kosovës
<b>LBGJ</b>	Ligji për Barazi Gjinore
<b>VV</b>	VETËVENDOSJE



## PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Barazia gjinore në pozita të larta vendimmarrëse në sektorin publik mbetet një objektiv i largët për institucionet publike dhe partitë politike në Kosovë. Edhe pse kemi Ligjin më të favorshëm për Barazi Gjinore në rajon, përmbushja e tij mbetet shumë e ulët. Ndonëse viteve të fundit retorika e zotimit ndaj LBGJ-së në sektorin publik ka qenë e bujshme, në realitet në agjendat e institucioneve publike dhe partive politike është vërejtur pak progres në përputhje me kërkesat minimale ligjore, të parapara me legjislacionin e Kosovës.

Qëllimi i këtij publikimi është të monitorojë pjesëmarrjen e grave në jetën publike dhe politike si dhe të identifikojë frenuesit dhe strategjitë e avokimit për rritjen e pjesëmarrjes së tyre. QKSGJ-ja zotohet të vazhdojë avokimin për këtë aspekt të pjesëmarrjes së grave. Ndikimi nga një pjesëmarrje e tillë nuk është i rëndësishëm vetëm për fuqizimin ekonomik dhe financiar të grave, por edhe për promovimin e vlerave themelore për barazi në sistemin publik në Kosovë

Bazuar në të dhënat e mbledhura nga institucionet përgjegjëse në nivel qendror, Qeveria, Presidenca dhe Kuvendi paraqesin një pasqyrë të ngjashme të zymtë në lidhje me barazinë gjinore në pozitat e larta vendimmarrëse. Derisa në vitin 2016 në Zyrën e Kryeministrit kanë qenë vetëm 11% gra të përfaqësuara në pozita të larta vendimmarrëse<sup>1</sup>, në Presidencë dhe Kuvend nuk ka pasur gra në pozita të tilla.

---

<sup>1</sup> Pozitat e larta në Zyrën e Kryeministrit përfshijnë pozitat e mëposhtme: Sekretari i Përgjithshëm, Kryeshefi Ekzekutiv dhe Drejtori Ekzekutiv

Kuota prej 30%<sup>2</sup> në Kuvend dhe Kuvendet Komunale ka qenë e suksesshme në mbajtjen e pjesëmarrjes së grave sipas kërkesave minimale të përcaktuara me ligj, mirëpo vazhdon të mos ketë përfshirje më të madhe të grave të emëruara në sektorin publik dhe parti politike.

Situata në nivel lokal është e ngjashme me atë të nivelit qendror, ku rrallë hasim në përfaqësim të grave në pozita të larta vendimarrëse. Gjithsesi, vlen të theksohet se krahasuar me pozitat e tjera (të emëruara) në institucionet publike, pozitat e kandiduara (në Kuvende) kanë përqindje shumë më të lartë të grave në shumicën e komunave të Kosovës<sup>3</sup>. Numri i përgjithshëm i përfaqësimit të grave në pozita të larta vendimarrëse në komuna në vitin 2014 ishte 4.4%, me një rritje të lehtë në përqindje prej 10.1% në vitin 2015 dhe 11.4% në vitin 2016.

Sa i përket përfaqësimit gjinor në pozita të larta vendimarrëse në agjenci të pavarura publike<sup>4</sup>, gjendja aktuale qëndron më keq se në nivelin lokal dhe atë qendror. Numri i përgjithshëm i përfaqësimit të grave në pozita të larta vendimarrëse në agjencitë e pavarura që ky hulumtim ka përfshirë është vetëm 20% apo 2 gra në këto pozita nga gjithsej 10 pozita. Kjo situatë ka qëndruar e pandryshuar përgjatë periudhës 2014-2016.

---

2 Ligji Nr. 03 / L-073 për Zgjedhjet Nacionale në Republikën e Kosovës. Shih gjithashtu Ligjin Nr. 03 / L-072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës.

3 Qendra Kosovare për Studime Gjinore: Pjesëmarrja e Grave në Vendimarrje në Kosovë

4 Agjencitë e pavarura të përfshira në këtë hulumtim janë: AMKMK, ASHMDHP, AKK, KQZ, KPMM, ARH, AKP, BQK, KPM, OShP

Partitë politike kanë rol vendimtar në rritjen e pjesëmarrjes së grave në politikë dhe rrjedhimisht edhe promovimin e vlerave demokratike. Bazuar në të dhënat e marra nga partitë kryesore parlamentare politike në Kosovë, nën-përfaqësimi i grave dëshmohet nga fakti se asnjë grua nuk ka dalë si një udhëheqëse, presidente apo zëvendëskryetare brenda partisë. Përveç kësaj, nuk ka dëshmi se gratë drejtojnë ndonjë nga degët që kanë partitë në Kosovë.

Ky hulumtim është pjesë e punës së vazhdueshme të QKSGJ-së në monitorimin e përfaqësimit të grave në sektorin publik dhe parti politike. QKSGJ-ja synon të vazhdojë monitorimin e këtij aspekti të barazisë gjinore dhe të avokojë për zbatimin e ligjeve në praktikë. Rëndësia e matjeve të tilla periodike qëndron në monitorimin e udhëheqësve politik dhe institucional për të marrë masa në përmirësimin e përfaqësimit gjinor dhe zbatimin e Ligjit për Barazi Gjinore. QKSGJ-ja ka bërë disa sugjerime dhe rekomandime rreth rritjes së zbatimit të LBGJ-së në sektorin publik.

## METODOLOGJIA

Metoda e përdorur për realizimin e hulumtimit është cilësore dhe ka për qëllim paraqitjen e informatave në mënyrë sistematike. Institucionet e përfshira në këtë hulumtim janë institucionet publike qendrore (Qeveria, Presidenca dhe Kuvendi), lokale (Komunat), Agjencitë e Pavarura Publike dhe Partitë Politike në Kosovë.

Ky raport hulumtues është realizuar si pjesë e projektit “Përmirësimi i Llogaridhënies për Barazi Gjinore në Vendimmarrje”, i cili ka për qëllim të rris infrastrukturën ekzistuese ligjore dhe institucionale për të avancuar integrimin gjinor dhe barazinë gjinore në të gjithë sektorin publik. Një pikë e rëndësishme që ky hulumtim synon të analizojë është krahasimi i pjesëmarrjes së grave në pozitat e larta vendimmarrëse përgjatë viteve. Afati kohor në të cilin është përqendruar ky hulumtim përfshin analizën për një periudhë tri vjeçare (2014-2016). Hulumtimi është kryer nga kompania hulumtuese AnketaCo dhe informatat janë marrë nga institucionet përkatëse për dhënien e informatave të paraqitura në raport. Më konkretisht, informatat (të dhënat parësore) në nivel qendror janë marrë nga Zyrtarja e Lartë për Burime Njerëzore në MAP, ndërsa informatat në nivel lokal janë marrë nga Zyrtarja e Zartë për Barazi Gjinore në MAPL. Informatat mbi partitë politike janë marrë përmes kontaktimit të Kryetareve të Forumeve të Grave brenda partive politike. Ndërkaq, të dhënat mbi agjencitë e pavarura janë marrë përmes kontaktimit të personave përgjegjës për dhënien e informatave në çdo agjenci si dhe nga të dhënat e tjera të marra edhe nga MAP.

Përveç kësaj, për të përfunduar interpretimin e të dhënave, ekipi i AnketaCo ka shqyrtuar materialet dytësore dhe të dhënat në dispozicion në sferën publike<sup>5</sup>, dokumentet relevante nga studimet e mëparshme të QKSGJ-së si dhe të dhëna parësore të papërpunuara nga burime të tjera. Gjatë kësaj kohe, stafi i QKSGJ-së ka redaktuar dhe rishikuar vazhdimisht të dhënat së bashku me AnketaCo për të nxjerrë përfundimet dhe rekomandimet e paraqitura në këtë hulumtim.

Një nga vështirësitë më të mëdha të këtij hulumtimi ka qenë mungesa e bashkëpunimit të disa agjencive të pavarura dhe partive politike në dhënien e informatave për pjesëmarrjen e grave në pozita të larta vendimmarrëse. Edhe brenda periudhës së zgjatur për dhënien e të dhënave, disa parti dhe agjenci të pavarura nuk kanë dërguar informatat përkatëse sipas kërkesës, ose kanë dërguar informata të pjesshme/jo të plota si dhe jo relevante me temën kryesore të këtij hulumtimi. Një vështirësi tjetër që është hasur gjatë analizimit të të dhënave të ofruara nga MAP-i, ishte mungesa e ndarjes së të dhënave për Zyrën e Kryeministrit. Bordet e agjencive të pavarura që veprojnë në kuadër të Zyrës së Kryeministrit janë përfshirë në pozitat e larta vendimmarrëse duke rezultuar kështu në ndryshim të rezultatit të përgjithshëm.

---

<sup>5</sup> Agjencia për Barazi Gjinore: Gratë në procesin e punës dhe vendimmarrjes në Kosovë  
Agjencia për Barazi Gjinore: Pjesëmarrja, roli dhe pozita e grave në institucionet qendrore, lokale dhe në partitë politike në Kosovë

## KORNIZA LIGJORE

Barazia gjinore si e drejtë themelore e njeriut është e përfshirë në Kushtetutën e Kosovës. Parimi i barazisë gjinore rregullohet nga Kushtetuta e Kosovës<sup>6</sup> dhe ligjet tjera të zbatueshme përmes legjislacioneve të ndryshme civile dhe penale, duke përfshirë paketën e legjislacionit për të drejtat e njeriut. Përveç kësaj, instrumentet dhe marrëveshjet e tjera ndërkombëtare për të drejtat e njeriut janë drejtpërdrejt të zbatueshme në Kushtetutën e Kosovës<sup>7</sup>. Ndër të tjera, Konventa mbi Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW)<sup>8</sup>, e miratuar në vitin 1979 nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së dhe e përshkruar si një projekt-ligj ndërkombëtar i të drejtave për gratë, është gjithashtu e përcaktuar në nenin 22 të Kushtetutës së Kosovës. Ndër të tjera, CEDAW rikujton që diskriminimi ndaj grave shkel parimet e barazisë së të drejtave dhe respektit të dinjitetit njerëzor, dhe është pengesë për pjesëmarrjen e grave në jetën politike, sociale, ekonomike dhe kulturore të vendeve të tyre në kushte të barabarta me burrat<sup>9</sup>.

Në vitin 2014, Qeveria e Kosovës ka miratuar Planin e parë Kombëtar të Veprimit<sup>10</sup> për zbatimin e Rezolutës 1325 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara për Gratë, Paqen dhe Sigurinë<sup>11</sup>, i cili ndër të tjera synon të rris pjesëmarrjen e grave në pozita vendimmarrëse.

6 Kushtetuta e Republikës së Kosovës Neni 7.2

7 Kushtetuta e Republikës së Kosovës Neni 22

8 Konventa mbi Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW)

9 Konventa mbi Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW)

10 Plani Kombëtar i Veprimit

11 Rezoluta 1325 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara për Gratë, Paqen dhe Sigurinë

Miratimi i një kornize përkatëse ligjore për arritjen e barazisë gjinore duke përfshirë Ligjin për Barazinë Gjinore<sup>12</sup> dhe Ligjin Kundër Diskriminimit<sup>13</sup> janë përpjekje të rëndësishme për të promovuar dhe mbrojtur të drejtat e njeriut më gjerësisht në Kosovë.

Ligji për Barazi Gjinore, i cili në vitin 2015 ka zëvendësuar ligjin e mëparshëm, në nenin 3 pika 1.15<sup>14</sup> përkufizon përfaqësimin e pabarabartë si përfaqësim të një gjinie nën pesëdhjetë për qind (50%) në çdo nivel të organit vendimmarrës në jetën politike dhe publike. I njëjti ligj, në nenin 6 dhe pikën 8<sup>15</sup>, siguron një përfaqësim minimal prej pesëdhjetë për qind (50%) për çdo gjini në nivelet më të larta të vendimmarrjes në sektorin publik. Diskriminimi gjinor përfshihet gjithashtu në nenin 1 të Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi<sup>16</sup>, i cili ndalon diskriminimin e drejtpërdrejtë ose të tërthortë në baza gjinore.

Megjithatë, duhet të theksohet se përkundër dispozitave ligjore nga LBGJ-ja, ato nuk janë zbatuar plotësisht, pasi që ato nuk përfshihen dhe pasqyrohen në ligje të tjera, siç është Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe Lokale<sup>17</sup>. Përderisa Ligji për Barazi Gjinore përcakton përfaqësim të barabartë (50%) të grave dhe burrave në të gjitha organet dhe institucionet shtetërore, Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe Lokale ka një kuotë përfaqësimi prej vetëm 30%. Prandaj, ky është një pasqyrim i qartë se ligjet që nuk reflektojnë me LBGJ-në kërkojnë ndryshime dhe amandamente shtesë.

---

12 Ligji Nr. 05 / L -020 për Barazi Gjinore

13 Ligji Nr. 05/L -021 për Mbrojtjen nga Diskriminimi

14 Ligji Nr. 05 / L -020 për Barazi Gjinore

15 Ligji Nr. 05 / L -020 për Barazi Gjinore

16 Ligji Nr. 05/L -021 për Mbrojtjen nga Diskriminimi

17 Ligji Nr. 03 / L-073 për Zgjedhjet Nacionale në Republikën e Kosovës. Shih gjithashtu Ligjin Nr. 03 / L-072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës.

Përkundër dispozitave ligjore, zbatimi i LBGJ-së kërkon përpjekje serioze dhe të vazhdueshme. Si rezultat mbesin shumë sfida të mëdha strukturore me ç'rast gratë vazhdojnë të mbesin të pa përfaqësuara në pozitat e larta vendimmarrëse në sektorin public dhe partite politike.



## INFORMATA HYRËSE

Pjesëmarrja e grave në pozita vendimarrëse në sektorin publik në Kosovë është ballafaquar me sfida dhe pengesa të panumërta gjatë dekadave. Problemet kryesore që ndërlidhen me pjesëmarrjen e ulët të grave në pozita të larta në sektorin publik në Kosovë lidhen me mentalitetin patriarkal<sup>18</sup>. Janë bërë disa përpjekje për të ndërmarrë masa të vazhdueshme institucionale dhe për të korigjuar dhe plotësuar boshllëqet ekzistuese.

Hapi i parë i rëndësishëm drejt përmirësimit të kësaj situate është bërë në vitin 2000 kur u prezantuan kuotat për përfaqësimin e grave në listat zgjedhore. Kuota kërkon që 30%<sup>19</sup> e ulëseve në Kuvendin e Kosovës dhe Kuvendet Komunale të rezervohen për gratë. Kjo masë filloi të tregojë gradualisht rezultatet e saj në jetën parlamentare të Kosovës duke pasur kështu ndikim në imazhin e përgjithshëm të politikës në Kosovë. Edhe pse kuota gjinore shpesh herë sfidahehet, me aplikimin e saj prej 30%, ka pasur një rritje të konsiderueshme të numrit të grave në kuvend dhe përmirësim në raportin gjinor në favor të grave krahasuar me periudhën para kuotave. Si rezultat, gratë tani mbajnë 32.5%<sup>20</sup> të ulëseve në Kuvendin e Kosovës. Me fjalë të tjera, në legjislaturën aktuale janë 39 deputete.<sup>21</sup>

18 Qendra për Studimeve Gjinore e Kosovës: Ndikimi i ligjit të Punës tek Gratë në Kosovë.

19 Ligji Nr. 03 / L-073 për Zgjedhjet Nacionale në Republikën e Kosovës. Shih gjithashtu Ligjin Nr. 03 / L-072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës.

20 Instituti Kombëtar Demokratik (NDI), Kosovë: Tejkalimi i Barrierave për Pjesëmarrjen Politike të Grave

21 Qendra Kosovare për Studime Gjinore: Pjesëmarrja e Grave në Vendimarrje në Kosovë

Përkundër këtyre ndryshimeve pozitive përmes sistemit të kuotës dhe përfaqësimit relativisht të lartë të grave në Kuvendin e Kosovës, një gjë e njëjtë nuk ka ndodhur në pozitat e tjera (të emëruara) në sistemin publik. Administrata publike në nivel lokal dhe qendror vazhdon të jetë e rezervuar për burrat, veçanërisht në nivelet e larta të vendimmarrjes. Duke pasur parasysh nivelin e politizimit të sistemit publik në Kosovë, mosbarazia gjinore në organet dhe pozitat e larta vendimmarrëse është e kushtëzuar edhe nga pozita e pafavorshme e grave brenda partive politike.


## TË GJETURAT KRYESORE

Qëllimi i këtij hulumtimi është vlerësimi i pjesëmarrjes së grave në pozita të larta vendimmarrëse në nivel qendror (Qeveri, Presidencë dhe Kuvend), nivel lokal (Komuna), Agjenci të Pavarura Publike dhe Partitë Politike në Kosovë. Seksionet në vijim paraqesin një pasqyrë të përfaqësimit të grave në pozitat më të larta vendimmarrëse të qeverisjes në institucionet e lartpërmendura publike.

### Gratë në pozitat e larta vendimmarrëse në Qeveri

Dega ekzekutive e shtetit në Kosovë mban kompetencat kyçe për hartimin e politikave të nevojshme për fuqizimin e gruas dhe promovimin e barazisë gjinore. Nëpërmjet Agjencisë për Barazi Gjinore në Zyrën e Kryeministrit, ekzekutivi mban përgjegjësinë e koordinimit të përpjekjeve për të arritur barazinë gjinore përmes rrjetit të tij të zyrtarëve për barazi gjinore në ministri dhe komuna. Megjithatë, edhe në nivel të qeverisë, përfaqësimi i grave në pozita të larta vendimmarrëse mbetet i ulët. Përderisa pjesëmarrja e përgjithshme e grave në nivele më të ulëta të hierarkisë është shumë më e lartë se ajo e pozitave të larta vendimmarrëse (përqindja e përgjithshme e grave të punësuar në administratë publike në Qeveri është 40.6% në 2016)<sup>22</sup>, në pozita të larta vendimmarrëse, prania e grave në këto pozita është mjaft e ulët. Në Grafikon 1 më poshtë paraqitet ilustrimi visual i përfaqësimit gjinor në Qeveri në këto pozita (Zyra e Kryeministrit dhe Ministritë) sipas viteve.

<sup>22</sup> Qendra Kosovare për Studime Gjinore: Pjesëmarrja e Grave në Vendimarrje në Kosovë




**Grafiku 1.** Pozitat e larta vendimarrëse në Qeveri sipas viteve

Sa i përket pozitave të larta vendimarrëse në Zyrën e Kryeministrit, ato vazhdojnë të jenë të dominuara nga burrat. Grafiku 2 ilustron përfaqësimin e burrave dhe grave në pozita të larta vendimarrëse<sup>23</sup> në Zyrën e Kryeministrit për tri vite (2014, 2015, 2016). Përqindja e grave në këto pozita mbetet marginale dhe arrin vetëm 11% apo 1 grua nga gjithsej 8 pozitat për vitin 2016<sup>24</sup>. Ndërkaq, sipas të dhënave gjatë viteve 2014 dhe 2015 nuk figurojnë të ketë pasur gra në këto pozita.

<sup>23</sup> Pozitat e larta në Zyrën e Kryeministrit i përfshijnë pozitat e mëposhtme: Sekretari i Përgjithshëm, Kryeshefi Ekzekutiv dhe Drejtori Ekzekutiv

<sup>24</sup> Në zyrën e Kryeministrit për pozita të larta vendimarrëse në vitin 2016 janë përfshirë edhe Agjencitë e Pavarura që veprojnë në kuadër të kësaj zyre.



**Grafiku 2.** Pozitat e larta vendimarrëse në Zyrën e Kryeministrit

Një situatë e ngjashme është evidentuar edhe në Ministrinë e Qeverisë së Kosovës. Tabela 3. ilustron përfaqësimin gjinor në pozitat e larta vendimarrëse në këto institucione përgjatë viteve 2014, 2015 dhe 2016. Siç mund të shihet në tabelë, në vitin 2014, 3 pozita, nga gjithsej 45 (6.7%), janë drejtuar nga gratë. Në dy vitet e ardhshme ka pasur një rënie në numrin e përgjithshëm të grave që përfaqësojnë pozitat e larta vendimarrëse. Në vitin 2015, 3 nga 58 pozita (5.2%) u drejtuan nga gratë dhe këto shifra u ulën edhe më tej në 2016, me vetëm 3 pozita që mbaheshin nga gratë nga gjithsej 61 (4.9%).

MAPL-ja në vitin 2016 ka shënuar një përmirësim të lehtë në përfaqësimin gjinor krahasuar me dy vitet e mëparshme. Në vitin 2014 dhe 2015, në MAPL pozita e lartë vendimarrëse u drejtua nga një burrë, ndërsa në vitin 2016 kjo pozitë u drejtua nga një

grua. Në mënyrë të ngjashme, në vitin 2014, MAP-i nuk kishte gra në pozita të larta vendimmarrëse, ndërsa në vitin 2015 dhe 2016, një grua ishte në krye të njërës prej tri pozitave të larta vendimmarrëse.

MPJ-ja është një nga shembujt e përkeqësimit të përfaqësimit gjinor në këto pozita. Përderisa në vitin 2014 kjo ministri nga gjithsej tre pozitat e larta vendimmarrëse kishe një grua (1 nga 4 në vitin 2015), në vitin 2016 kjo ministri nuk kishte asnjë grua në pozita të tilla. Ministria e Tregtisë dhe Industrisë ka regjistruar gjithashtu një trend negativ në aspektin e përfaqësimit gjinor në pozita të larta vendimmarrëse në tri vitet e fundit. Në vitin 2014 në MTI, 2 nga 7 pozita të larta vendimmarrëse u drejtuan nga gratë, ndërsa ky numër është zvogëluar në 1 nga 7 pozitat në dy vitet në vijim.

	2014	2015[1]	2016
Pozitat e larta vendimmarrëse	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë (2/7)	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë (1/7)	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë (1/7)
	Ministria e Punëve të Jashtme (1/3)	Ministria e Administratës Publike (1/3)	Ministria e Administratës Publike (1/3)
		Ministria e Punëve të Jashtme (1/4)	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (1/1)
	3 nga 45 (6.7%)	3 nga 58 (5.2%)	3 nga 61 (4.9%)

**Tabela 3.** Pozitat e larta vendimmarrëse në Qeveri sipas viteve

## Gratë në pozita të larta vendimmarrëse në Kuvend

Dega legjislative e shtetit ka përmbushur me sukses përfaqësimin prej 30% të grave deputete në Kuvendit; Megjithatë, ajo nuk ka arritur të veprojë në përputhje me LBGJ-në jashtë kuvendit dhe ta bëjë atë pjesë të infrastrukturës ligjore të vendit. Përkundër ndryshimeve pozitive dhe rritjes së numrit të grave që kanë ulëse në Kuvend, situata me gratë në shërbimin civil është krejtësisht ndryshe dhe në kundërshtim me LBGJ-në.

Që nga fillimi i monitorimit të parë të QKSGJ-së në vitin 2013, Kuvendi i Kosovës nuk ka bërë përpjekje për të përmirësuar përfaqësimin gjinor të shërbyesve civil në pozitat e larta vendimmarrëse<sup>25</sup>. Në vitin 2016, si në dy vitet e mëparshme të përfshira nga ky hulumtim, nuk ka gra në pozita të larta vendimmarrëse. Të tri pozitat e larta drejtuese në Kuvend mbahen nga burrat.

## Gratë në pozita të larta vendimmarrëse në Presidencë


Presidenca, si një nga institucionet kyçe kushtetuese, vazhdon të rezervojë pozitat e larta vendimmarrëse vetëm për burrat. Që nga viti 2013, kur QKSGJ-ja ka filluar aktivitetet e saj të monitorimit, Zyra e Presidentit nuk ka emëruar ndonjë grua në pozita të larta vendimmarrëse duke vepruar kështu në kundërshtim me LBGJ-në.

## Gratë në pozita të larta vendimmarrëse në komuna

Duke patur parasysh shkallën e decentralizimit në Kosovë, të shoqëruar me numrin e madh të komunave (në raport me

<sup>25</sup> Pozitat e larta në Kuvend përfshijnë pozitat e mëposhtme: Sekretari i Përgjithshëm, Kryeshefi Ekzekutiv dhe Drejtori Ekzekutiv

madhësinë), niveli i qeverisjes lokale ka rëndësi të veçantë për Kosovën. Situata me pozita të larta vendimmarrëse<sup>26</sup> në komuna është shumë më e zyrtë krahasuar me pjesën tjetër e pozitave kandiduese të qeverisë komunale. Bazuar në gjetjet e hulumtimit, përfaqësimi i përgjithshëm i grave në pozitat e larta vendimmarrëse komunale është pak më i mirë krahasuar me nivelin qendror përgjatë periudhës trevjeçare që përfshin ky hulumtim por ende mbetet në një nivel relativisht të ulët. Grafiku më poshtë paraqet përfaqësimimin gjinor në komuna sipas viteve.



**Grafiku 4.** Pozitat e larta vendimmarrëse në komuna - Drejtorët e Drejtorive Komunale.


Në vitin 2014, vetëm 12 komuna kishin gra drejtore (Vetëm 14 prej 301 pozitave të drejtorëve në tërë Kosovën u drejtuan nga gratë)<sup>27</sup>.

<sup>26</sup> Pozitat e larta vendimmarrëse në komuna përfshijnë pozitën: Drejtorët e Drejtorive Komunale

<sup>27</sup> Sipas të dhënave të siguruar nga MAPL



Numri më i madh i grave në këto pozita në vitin 2014, është raportuar në komunën e Fushë Kosovës dhe Gjakovës, ku secila ka 2 gra në pozita të drejtores. Grafiku 9 ilustron përfaqësimin gjinor në këto pozita në administratat komunale, siç është raportuar në vitin 2014.




**Grafiku 5.** Pozitat e larta vendimarrëse në Komuna në vitin 2014<sup>28</sup>

Në vitin 2015, gjendja e përgjithshme e përfaqësimit të grave në pozita të larta vendimarrëse në komuna është përmirësuar duke marrë parasysh numrin e ulët të komunave që kanë pasur gra drejtoreshë në vitin 2014. Në vitin 2015, numri më i lartë i përfaqësimit të grave në pozita të larta vendimarrëse është regjistruar në komunën e Vushtrrisë, Fushë Kosovës dhe Kamenicës me 3 pozita në secilën komunë.

<sup>28</sup> 28 Komunat pa asnjë grua në pozita të larta vendimarrëse në vitin 2014 janë: Gjilani, Peja, Vushtrria, Suhareka, Shtimja, Ferizaji, Mitrovica, Obiliqi, Juniku, Istogu, Mamusha, Malisheva, Skenderaji, Dragashi, Parteshi, Klina, Kaçaniku, Podujeva, Rahoveci, Deçani, Hani i Elezit.

Komunat me përkeqësim më të madh të përfaqësimit të grave në pozita të larta vendimmarrëse janë komuna e Kllokotit, Graçanicës, Novobërdës dhe Shtërpcës, ku sipas të dhënave asnjëra prej tyre nuk ka arritur të ofrojë pozita të tilla për gratë në vitin 2015.

Komunat me gra drejtore në administratat e tyre për vitin 2015 janë paraqitur në grafikun e mëposhtëm.




**Grafiku 6.** Pozitat e larta vendimmarrëse në komuna në vitin 2015<sup>29</sup>

<sup>29</sup> Komunat pa asnjë grua në pozita të larta vendimmarrëse në vitin 2015 janë: Deçani, Dragashi, Gjiçani, Graçanica, Istogu, Kaçaniku, Kllokoti, Mamusha, Mitrovica, Novobërda, Podujeva, Rahoveci, Shtërpca dhe Suhareka.

Në vitin 2016, vërehet një rritje në numrin e komunave që kanë gra drejtore të drejtorive. Komuna e Drenasit ka treguar progres në rritjen e numrit të grave në pozita të larta vendimmarrëse në vitin 2016 krahasuar me dy vitet e mëparshme. Në vitin 2016, Drenasi kishte 5 gra drejtore të drejtorive, që do të thotë 4 gra më shumë krahasuar me vitin 2015. Komuna e Gjakovës në vitin 2016 kishte 4 gra në pozita të larta vendimmarrëse, 2 gra më shumë krahasuar me vitin 2015. Fushë Kosova, Kamenica dhe Vushtrria secila kishin nga 3 gra në pozita të larta vendimmarrëse.

Në disa komuna, progresi i arritur në vitin 2015 sa i përket përmirësimit të përfaqësimit gjinor u ndërpre dhe mbeti i njëjtë gjatë vitit 2016. Pasqyra e këtyre ndryshimeve është paraqitur në grafikun e mëposhtëm:



**Grafiku 7.** Pozitat e larta vendimmarrëse në komuna në vitin 2016<sup>30</sup>

Vlen të theksohet se komunat e Zveçanit, Zubin Potokut dhe Leposaviqit nuk janë përfshirë në të dhënat e ofruara nga MAPL-ja për periudhën ndërmjet viteve 2014-2016.

<sup>30</sup> Komunat pa asnjë grua në pozita të larta vendimmarrëse në vitin 2016 janë: Dragashi, Gjilani, Graçanica, Kaçaniku, Klllokoti, Mamusha, Mitrovica, Novobërda, Podujeva, Rahoveci dhe Suhareka.

Pozitat e larta vendimmarrëse në komunat e Kosovës vazhdojnë të kryesohen nga burrat. Numri i përgjithshëm i përfaqësimit të grave në pozita të larta vendimmarrëse në komuna në vitin 2014 ishte 4.4%, me një rritje të lehtë në përqindje në vitin 2015 me 10.1% dhe 11.4% në vitin 2016.


### **Gratë në pozitat e larta vendimmarrëse në agjenci të pavarura**

Agjencitë e pavarura janë një komponent tjetër i rëndësishëm i këtij hulumtimi. Nga 24 agjenci të kontaktuara, vetëm 10 prej tyre u përgjigjën duke ofruar të dhëna. Në shumicën e agjencive të dhënat e përfshira nuk ishin relevante për hulumtimin me ç'rast informata të tjera janë marrë edhe nga MAP.

Agjencitë e pavarura, krahasuar me institucionet e nivelit qendror dhe lokal, qëndrojnë më keq në aspektin e përfaqësimit gjinor të barabartë në pozita të larta vendimmarrëse<sup>31</sup>. Grafiku 12 ilustron përfaqësimin gjinor në dhjetë agjencitë e pavarura që ky hulumtim përfshin për periudhën tre vjeqare, meqë asnjë ndryshim nuk është regjistruar gjatë këtyre viteve sa i përket përfaqësimit gjinor në pozitat e larta vendimmarrëse në agjencitë e pavarura.

---

31 Pozitat e larta në agjencitë e pavarura përfshinë një nga pozitat e mëposhtme: Sekretari i Përgjithshëm, Kryeshefi Ekzekutiv dhe Drejtori Ekzekutiv



**Grafiku 8.** Pozita të larta vendimarrëse në Agjencitë e Pavarura në Kosovë sipas viteve 2014-2016<sup>32</sup>

Sipas të dhënave të ofruara KPM dhe KQZ rezultojnë të jenë të vetmet agjenci në të cilat pozita e lartë vendimarrëse drejtohet nga gratë. Në të gjitha agjencitë tjera të përfshira në këtë hulumtim këto pozita drejtohen nga burrat.

### Gratë në pozita të larta vendimarrëse në partitë kryesore politike

Partitë politike janë disa nga subjektet më me ndikim në Kosovë. Administrata publike shpesh është kritikuar se është e tejpolitizuar dhe qeveriset nga partitë politike. Brenda strukturave të partive politike, gratë tradicionalisht kanë qenë në një pozitë

<sup>32</sup> Agjencitë e pavarura të përfshira në këtë hulumtim janë: AMKMK, ASHMDHP, AKK, KQZ, KPMM, ARH, AKP, BQK, KPM, OShP

të margjinalizuar. Duke pasur parasysh ndikimin që partitë politike kanë mbi sistemin publik, pjesëmarrja e limituar grave në strukturat brenda partive politike, ka penguar që ato të jenë pjesë e vendimmarjes në institucionet publike, veçanërisht në pozitat e larta vendimmarrëse.


Përderisa për pozitat dhe funksionet e rregulluara nga Ligji për Zgjedhjet (të përgjithshme dhe lokale), përfaqësimi i grave është siguruar përmes kuotës 30%, pjesëmarrja e grave në pozita të larta vendimmarrëse brenda strukturave të partive politike vazhdon të jetë e ulët.

### **Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK)**

Sipas të dhënave nga Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), përfaqësimi i grave brenda strukturave të kësaj partie mbetet i ulët. Pozitat e larta në këtë parti politike vazhdojnë të jenë të dominuara nga burrat. Gjithashtu, duke qenë pjesë e kompozimeve qeveritare më shumë se çdo parti tjetër politike në Kosovë, LDK-ja nuk ka treguar angazhim për përfshirjen e grave në pozitat e larta vendimmarrëse.

Sa i përket përfaqësimit gjinor brenda strukturës së menaxhimit të partive politike, LDK-ja rangohet më e ulëta nga të gjitha partitë politike që kanë dërguar të dhënat e përfaqësimit gjinor. Brenda LDK-së, nuk ka gra zëvendës kryetare, kryesuese, apo kryetare të degëve. Dy strukturat kryesore të partisë, Kryesia dhe Asambleja e Përgjithshme kanë përkatësisht 17% dhe 18% gra të përfaqësuara. Pjesëmarrja e moderuar e grave në strukturat udhëheqëse brenda partisë është një dëshmi e strukturës politike të mbizotëruar nga burrat ku pak gra arrijnë nivelet më të larta të pushtetit dhe

ndikimit. Grafiku 10 paraqet përfaqësimin gjinor në strukturat e larta vendimmarrëse brenda LDK-së.




**Grafiku 9.** Pozitat e larta vendimmarrëse në LDK 2014-2016

## VETËVENDOSJE! (VV)

VETËVENDOSJE! Lëvizja Vetëvendosje është një nga forcat më të reja politike në Kosovë. Krahasuar me partitë e tjera politike, Vetëvendosja është renditur më së miri sa i përket përfaqësimit gjinor në strukturat udhëheqëse të saj. Në VV 26% e anëtarëve të Kryesisë janë gra. Kjo është përqindja më e lartë e grave në kryesitë e partive siç janë raportuar nga vetë partitë politike. Këshilli i Përgjithshëm, i cili është një tjetër strukturë kryesore e partisë, përfshin 25% të grave në përbërjen e saj. Kjo është gjithashtu shkalla më e lartë e përfaqësimit në nivelin e Këshillit të Përgjithshëm në cilëndo nga



partitë që kanë raportuar përfaqësimin e tyre gjinor. Por edhe brenda VV, sipas të dhënave të siguruara nga kjo parti nuk ka gra zëvendës kryetare, kryesuese, apo kryetare të degëve. Grafiku 11 tregon përfaqësimin gjinor brenda strukturave udhëheqëse të VV-së.




**Grafiku 10.** Pozitat e larta vendimmarrëse në VV 2014-2016

### Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK)

Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës sa i përket pjesëmarrjes së grave në strukturat e larta vendimmarrëse brenda strukturave të saj, është e renditur më lartë krahasuar me LDK-në por më ulët krahasuar me VV.

AAK raporton se 19% e anëtarëve të kryesisë së saj janë gra, që është 2% më e lartë se në LDK dhe 7% më e ulët se në VV. Këshilli

i Përgjithshëm, si organi më i lartë vendimmarrës në të gjitha partitë, në AAK përbëhet nga 20% gra dhe 80% burra. Edhe në këtë strukturë, AAK-ja ka një shkallë më të lartë se LDK-ja (me 2%) dhe më të ulët se VV (me 5%). Edhe AAK ka mungesë të grave në pozitat e zëvendës kryetares, kryesueses, apo kryetares të degëve. Grafiku 12 në vijim paraqet strukturën gjinore në AAK.



**Grafiku 11.** Pozitat e larta vendimmarrëse në AAK 2014-2016

# PËRFUNDIMET DHE REKOMANDIMET

## Përfundimet

Siç dëshmohet nga të dhënat e paraqitura në këtë raport, nëntë vjet pas pavarësisë dhe shtatëmbëdhjetë vjet në procesin e shtetndërtimit, sektori publik dhe partitë politike të Kosovës nuk kanë arritur të përmbushin LBGJ-në. Përderisa legjislacioni gjinor është avancuar dhe paraqet arritje të mëdha, zbatimi i tij i ulët në të gjitha institucionet publike dëshmon dominimin e perceptimit patriarkal rreth zbatimit të LBGJ.

Në bazë të të dhënave të ofruara nga institucionet përkatëse, përfaqësimi i grave në ministritë për vitin 2014 ishte vetëm 6.7%, 5.2% në vitin 2015 dhe 4.9% në vitin 2016. Institucionet tjera të nivelit qendror, Presidenca dhe Kuvendi, nuk kanë arritur të përmbushin LBGJ-në gjatë periudhës 2014-2016.

Numri i përgjithshëm i përfaqësimit të grave në pozita të larta vendimmarrëse në komuna në vitin 2014 ishte 4.4%, me një rritje të lehtë në përqindje në vitin 2015 me 10.1% dhe 11.4% në vitin 2016.

Gjendja e përfaqësimit të grave në pozita të larta vendimmarrëse në agjencitë e pavarura vazhdon të jetë e pafavorshme. Këto institucione kanë dështuar të jenë në përputhje me LBGJ-në gjatë periudhës tre vjeqare që mbulon ky hulumtim. Gjatë kësaj periudhe asnjë ndryshim nuk është regjistruar sa i përket përfaqësimit gjinor në pozitat e larta vendimmarrëse në agjencitë e pavarura. Numri i përgjithshëm i përfaqësimit të grave në pozita të larta vendimmarrëse në agjencitë e pavarura që ky hulumtim ka përfshirë është vetëm 20% apo 2 gra në këto pozita nga gjithsej 10 pozitat.

Partitë politike, përmes përfaqësimit të tyre në Kuvendin e Kosovës, janë identifikuar gjithashtu si njësi kryesore përgjegjëse për kuadrin e përgjithshëm ligjor dhe politik dhe për promovimin e barazisë gjinore. Megjithatë, ato nuk arritën të vepronin në përputhje me LBGJ-në në strukturat e tyre të brendshme vendimmarrëse. Pozitat e tyre të larta vendimmarrëse mbetën të pandryshuara gjatë gjithë periudhës 2014-2016 duke mos shënuar kështu ndonjë regres apo progres lidhur me këtë çështje. Partia me përfaqësim më të mirë në strukturat e brendshme të saj është VV-ja me 26% gra anëtare në kryesinë e saj, pasuar me 19% gra anëtare në kryesinë e AAK-së si dhe 17% gra anëtare në kryesinë e LDK-së.

### **Sugjerimet dhe rekomandimet**

QKSGj-ja, duke pasur parasysh masat optimale që mund të avancojnë në mënyrë efektive përfaqësimin e barabartë gjinor në jetën publike dhe politike në Kosovë, jep rekomandimet në vijim:

Rekomandohet MAP-i që ti publikojë statistikën dhe të dhënat e mbledhura në lidhje me institucionet publike në faqen e tyre zyrtare; për ta bërë këtë informatë lehtësisht të arritshme për të gjitha palët e interesuara. Gjithashtu rekomandohet që të bëhet ndarja e të dhënave sipas gjinisë.

Rekomandohet MAP-i që t'i mbledh dhe raportojë të dhënat për qeverinë në mënyrë të ndarë nga agjencitë e saj të ndërlidhura. Mungesa e ndarjes së të dhënave të mbledhura nga agjencitë e ndërlidhura rezulton në ndryshimin e rezultatit të përgjithshëm të përfaqësimit të grave në pozita të larta vendimmarrëse, duke mos pasqyruar kështu rezultatin e saktë.

Rekomandohet që kuotat gjinore të mbeten si një mekanizëm efektiv për rritjen e përfaqësimit politik të grave.

Rekomandohet që kuota gjinore të aplikohet jo vetëm në përfaqësimin politik, por edhe në strukturat vendimmarrëse të partive politike.

Rekomandohet Avokati i Popullit të ndërmerr veprime ligjore kundër shkelësve të LBGJ-së. Proceset gjyqësore që mund të ndiqen përmes sistemit gjyqësor do të shërbejnë gjithashtu si avokim për rishikimin e LBGJ-së dhe futjen e dënimit më të ashpër të shkeljes së tij.

## REFERENCAT

Agjencia për Barazi Gjinore: Pjesëmarrja, roli dhe pozita e grave në institucionet qendrore, lokale dhe në partitë politike në Kosovë  
Në dispozicion në: <http://abgj.rks.gov.net/Portals/0/ABGJ%20Pjesmarrja%20roli%20dhe%20poziat%20e%20grave%20ne%20institucione%20qendrore%20lokale%20dhe%20parti%20politike.pdf>

Agjencia për Barazi Gjinore: Gratë në procesin e punës dhe vendimmarrjes në Kosovë. Në dispozicion në:<http://abgj.rks-gov.net/Portals/0/Raportit%20i%20hulumtimtit%20%22Grat%20C3%AB%20n%20C3%AB%20procesin%20e%20punes%20dhe%20Vendimarrjes%20%20shqip%20A5%20-%2088%20faqe.pdf>

Deklarata e Vjenës, Konferenca Botërore për të Drejtat e Njeriut, Vjenë, 14 - 25 Qershor 1993, U. N. Doc. A / CONF.157 / 24 (Pjesa I) në 20 (1993). Universiteti i Minesotës, Biblioteka e të Drejtave të Njeriut. Në dispozicion në: <http://hrlibrary.umn.edu/instree/l1viedec.html>

Imazhi i Grave Politikane në Qendrën Kosovare për Studime Gjinore në Kosovë. Në dispozicion në: <http://www.kgscenter.net/wp-content/uploads/2015/07/10.-Analysis-of-the-image-of-women-politicians-in-the-kosovar-media.pdf>

Instituti Kombëtar Demokratik (NDI), Kosovë: Tejkalimi i Barrierave për Pjesëmarrjen Politike të Grave në dispozicion në:<https://www.ndi.org/sites/default/files/Gender-Assesment-report-eng.pdf>

Kushtetuta e Republikës së Kosovës. Kuvendi i Kosovës. Në dispozicion në:<http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Kushtetuta.e.Republikes.se.Kosoves.pdf>

Konventa mbi Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW) Në dispozicion në:<http://www.un.org/womenwatch/daw/cedaw/>

Konventa mbi Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW) Në dispozicion : <http://abgj.rks-gov.net/Portals/0/Konvent%20CEDAW.pdf>

Ligji Nr. 05/L -020 për Barazinë Gjinore Në dispozicion në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=10923>

Ligji Nr. 05/L -021 për Mbrojtjen nga Diskriminimi në dispozicion në:<https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=10924>

Ligji Nr. 03 / L-073 për Zgjedhjet Nacionale në Republikën e Kosovës në dispozicion në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2549>

Ligji Nr. 03 / L-072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës në dispozicion në:

<https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2549>

Ministria e Integritimit Evropian dhe Qendra e Studimeve Gjinore në Kosovë: Integrimi Evropian dhe Barazia Gjinore. Në dispozicion në: <http://www.kgscenter.net/wp-content/uploads/2017/01/European-Integration-and-Gender-Equality-1.pdf>

Plani Kombëtar i Veprimit në dispozicion në: <http://www.peacewomen.org/nap-kosovo>

Qendra Kosovare për Studime Gjinore: Pjesëmarrja e Grave në Vendimarrje në Kosovë

[http://www.kgscenter.net/wp-content/uploads/2015/05/Womens-participation-in-decision-making-in-Kosovo\\_ALB.pdf](http://www.kgscenter.net/wp-content/uploads/2015/05/Womens-participation-in-decision-making-in-Kosovo_ALB.pdf)


Qendra Kosovare për Studime Gjinore: Si votojnë gratë në Kosovë: Opinionet e Grave të Kosovës, prioritetet dhe pjesëmarrja politike. Në dispozicion në: <http://www.kgscenter.net/wp-content/uploads/2015/07/1.-How-do-Women-Vote-in-Kosova.pdf>

Qendra Kosovare për Studime Gjinore: Ndikimi i ligjit të Punës tek Gratë në Kosovë në dispozicion në: <http://www.kgscenter.net/wp-content/uploads/2015/05/NdikimiiligjितtePunestekGratenekosove.pdf>

Rezoluta 1325 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara për Gratë, Paqen dhe Sigurinë: <https://www.un.org/ruleoflaw/files/womenpeaceandsecurity.pdf>



MINISTRY OF FOREIGN AFFAIRS OF DENMARK  
**DANIDA** | INTERNATIONAL  
DEVELOPMENT COOPERATION

 Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra  
Swiss Cooperation Office Kosovo

Ky grant financohet nga projekti Promovimi i Shoqërisë Demokratike (PSHD) -i financuar nga Zyra Zvicerane e Bashkëpunimit në Kosovë dhe Ministria e Punëve të Jashtme të Danimarkës (DANIDA) dhe menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (FKSHC).





